



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 235, Datë 18.08.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 44, DATË 11.02.2026,
“MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “PARISOL” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 175/7 prot., datë 13.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k”.

Konstatohet se:

- Shoqëria “PARISOL” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, i ndryshuar, për centralin fotovoltaik me kapacitet 2 MW në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 44, datë 11.02.2026 ka miratuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të informojë ERE-n menjëherë pasi të disponojë/marrë miratimin përkatës të “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. (konfirmimin nga banka mëmë), në lidhje me dakortësinë për ndryshimin e ortakut të shoqërisë, lidhur me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontratat e kredive të nënshkruara me bankën më datë 18.04.2025.
- Në kuadër të përmbushjes së këtij kushti, me shkresën e fundit të përcjellë nr. 175/6 prot., datë 06.08.2026, shoqëria ka përcjellë deklaratën noteriale, datë 05.08.2026, të lëshuar nga “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a., e cila ka dhënë pëlqimin/dakortësinë për transferimin e kuotës të zotëruar nga ortakut z. M D te z. A Sh. Nëpërmjet kësaj deklarate, banka shprehet se për efekt regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), jep miratimin që z. M D (zotërues i 70% të kuotave të shoqërisë), të kalojë titullin e pronësisë të kuotave që zotëron te z. A Sh.

- Në rrethanat kur kushti i parashikuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 44/2026 tashmë është përmbushur, vlerësohet se kjo pikë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, me shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 44/2026, vlerësohet e nevojshme edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi nga “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 2, si dhe në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje” në “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje”.
- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, si vijon:
 - a. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, shfuqizohet.
 - b. Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “PARISOL” sh.p.k për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI